

RAPORTIMI JAVOR

PËRGATITËR NGA: ZJ. STOLI LAZE, Auditues Ligjor
DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR ZGJEDHOR
DATA: 24/06/2019
OBJEKTI: Raporti javor i ndërmjetëm i monitorimit

Monitorues/Eksperti financiar: **ZJ. STOLI LAZE**

Zgjedhjet: **ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019**

Partia/subjekti elektoral: **PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE**

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:

- **QARKU TIRANË**
 - **BASHKIA TIRANË**
- **QARKU KUKËS**
 - **BASHKIA KUKËS**
 - **BASHKIA HAS**
 - **BASHKIA TROPOJË**
- **QARKU DIBËR**
 - **BASHKIA MAT**
 - **BASHKIA BULQIZË**
- **QARKU SHKODËR**
 - **BASHKIA MALËSI E MADHE**
- **QARKU ELBASAN**
 - **BASHKIA ELBASAN**
 - **BASHKIA LIBRAZHË**
 - **BASHKIA GRAMSH**



- **QARKU GJIROKASTËR**
 - **BASHKIA KËLCYRË**

Shkefjet e mundëshme të identifikuar të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore:

Zyrat elektorale

Nga monitorimi kryer prej datës **17 Qershor 2019** deri më **23 Qershor 2019** rezulton sa më poshtë:

Zyrat Elektorale / Zyra e lagjeve / zgjedhjeve,

- Kemi marrë përgjigje me shkresë zyrtare me postë, nga Bashkia Tiranë, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Tropojë, Bashkia Gramsh, Bashkia Has, për informacione për zyrat elektorale të partisë së sipër përmendur, në kuadër të detyrimit ligjor të subjekteve zgjedhore të deklarimit të vendodhjes së zyrave elektorale në këto bashki. Te gjitha këto bashki na informojnë se Partia e Reformave Demokratike Shqiptare nuk ka dhënë informacion mbi adresat e sakta të zyrave elektorale në territorin e këtyre bashkive.
- Nuk kemi identifikuar asnjë zyrë elektorale nga monitorimi në terren.
- Nga kontakti i vendosur me kryetarin e subjektit zgjedhor Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, z. Krenar Rryçi, na është komunikuar prej tij që nuk ka zyra elektorale. Ngelet për t'u verifikuar.

Natyra e shkeljeve:

- Nuk është zbatuar detyrimi që i lindi subjektit Partia e Reformave Demokratike Shqiptare ashtu siç percaktohet në pikën 3 të Udhëzimit nr1 date 31.05.2017 "Për pëdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore" i ndryshuar

Materiale të fushatës të ndaluara

- Gjatë monitorimit të kryer nuk kemi vërejtur ende, materiale të ndaluara gjatë fushatës.

Eksperti Financiar

Auditues Ligjor

Stoll



Miratuar me Vendim nr. 152 datë 31.04.2019